



VENDIM

Nr. 139 Datë 07.12.2011

PËR

**SHQYRTIMIN E APLIKIMIT TË OST SH.A PËR MIRATIMIN E
PLANIT TË INVESTIMEVE PËR PERIUDHËN E TRETË
RREGULLATORE 2012 – 2014**

Në mbështetje të neneve 9 dhe 24, të Ligjit Nr. 9072, datë 22.05.2003, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, të ndryshuar, neneve 9 dhe 11, të Rregullores për Proçedurat e Paraqitjes dhe Miratimit të Planit të Investimeve nga të Liçensuarit në Sektorin e Energjisë Elektrike, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 07.12.2011, pasi shqyrtoi kërkesën e shoqërisë OST sh.a dhe u njoh me relacionin e përgatitur nga grupi i punës,

Konstatohet se:

Aplikimi i OST sh.a për Planin e Investimeve për periudhën e tretë Rregullatore 2012-2014 në përgjithësi është në përputhje me kërkesat e neneve 9 dhe 11 të Rregullores për Proçedurat e Paraqitjes dhe Miratimit të Planit të Investimeve nga të Liçensuarit në Sektorin e Energjisë Elektrike.

Për gjithë sa më sipër Bordi i Komisionerëve të ERE-s,

Vendosi :

1. Të miratojë aplikimin e shoqërisë OST sh.a për miratimin e Planit të Investimeve të për periudhën e tretë rregullatore 2012 – 2014.
2. Ngarkohet Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit për njoftimin e OST sh.a.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Sokol RAMADANI